

Nr: 10-67

Shkup: 24.03.2025

---

Në bazë të nenit 10, nenit 15 paragrafi (5) dhe nenit 16 paragrafi (2) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës dhe njoftimit për informata shtesë për formularin e njoftimit për ndihmë rajonale nr. 10-153 të datës 21.11.2022, të parashtruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë përgjegjës për çështje ekonomike, koordinim me resorët ekonomikë dhe investime, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 24.03.2025, miratoi këtë

### AKTVENDIM

- Masat e parapara në pikën 4 të Njoftimit dhe nenin 4 të Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod, për:
- pagesën e pjesës proporcionale të tatimit të paguar mbi fitimin, që ka të bëjë dhe rrjedh ekskluzivisht nga Projekti investues i përshkruar në planin afarist, i llogaritur dhe i paguar në përputhje me Ligjin për tatimin mbi fitimin, për periudhë deri në 10 (dhjetë) vite, duke filluar nga Data e fillimit;
- pagesën në formë të grantit në para në lartësi prej 10% të shumës së Shpenzimeve të arsyeshme investuese të realizuara nga Pala e Dytë, por jo më shumë se 2.000.000 euro (dy milionë euro) në kundërvlerë denari, në nivel vjetor, në periudhë prej 5 (pesë) viteve nga Data e fillimit;
- pagesën shtesë në favor të Palës së Dytë në formë të grantit në para në lartësi prej 10% të shumës së Shpenzimeve të arsyeshme investuese të realizuara nga Pala e Dytë, por jo më shumë se 2.000.000 euro (dy milionë euro) në kundërvlerë denari, në nivel vjetor, në periudhë prej 5 (pesë) viteve nga Data e fillimit, nëse Pala e Dytë e mban ose e zvogëlon numrin mesatar të të punësuarve për më pak se 5% në vitin e fundit në krahasim me numrin mesatar të të punësuarve në tre vitet paraprake dhe i rrit të hyrat e përgjithshme për më shumë se 5% në vitin e fundit në krahasim me të hyrat e përgjithshme mesatare në tre vitet paraprake,

paraqesin **ndihmë shtetërore, ndarja e së cilës nuk lejohet** në përputhje me nenin 15 paragrafi (5) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore.

### A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KMK) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të mbështetjes, përkatësisht nëse e njëjta paraqet ose nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore (i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore) është i obliguar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, që KMK-së t'i dorëzojë njoftim për çdo plan për ndarjen e ndihmës së re ose ndryshimin e ndihmës ekzistuese shtetërore, pa marrë parasysh nëse e njëjta ndahet si ndihmë individuale ose si skemë ndihme.

Duke vepruar në përputhje me obligimin për njoftim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhënëse e ndihmës shtetërore, përmes Zëvendëskryetarit të Qeverisë përgjegjës për çështje ekonomike, koordinim me resorët ekonomikë dhe investime, Fatmir Bytyqi, me shkresën nr. 09-10517/1 të datës 17.11.2022 (Nr. ynë 10-153 i datës 21.11.2022), dorëzoi Njoftim për ndarjen e planifikuar të ndihmës shtetërore Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod dhe Formularin 1 – Informata shtesë për formularin e njoftimit për ndihmë rajonale, Marrëveshje (e panëshkruar) për ndarjen e ndihmës shtetërore ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod, Letër qëllimi nga ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod dhe Plan afarist nga ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod.

KMK vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar për ndarjen e planifikuar të ndihmës nr. 09-10517/1 të datës 17.11.2022, përkatësisht Formulari 1 – Informata shtesë për formularin e njoftimit për ndihmë rajonale, nuk i përmban të dhënat e nevojshme për vlerësimin e ndihmës dhe kërkoi nga dhënësi i ndihmës shtetërore plotësimin e plotë të Formularit 1 të lartpërmendur. Dhënësi i ndihmës shtetërore veprroi sipas kërkesës së KMK-së dhe dorëzoi Formularin 1 të plotësuar – Informata shtesë për formularin e njoftimit për ndihmë rajonale – shkresa nr. 09-111/4 nga janari 2023 (Nr. ynë 10-1 i datës 02.02.2023).

Për shkak të vlerësimit të projektit investues të kompanisë dhe masave të dizajnuara për mbështetje, KMK me shkresat nr. 10-153 të datës 28.11.2022, 10-1 të datës 03.01.2023, 10-1 të datës 28.02.2023, 10-1 të datës 03.04.2023, 10-1 të datës 08.05.2023 dhe 10-1 të datës 20.07.2023 kërkoi të dhëna dhe informata shtesë.

Dhënësi i ndihmës, me shkresat nr. 09-10517/7 të datës 09.12.2022, 09-111/4 nga janari 2023, 09-111/8 të datës 10.03.2023, 09-4045/1 të datës 19.04.2023, 09-4045/3 të datës 22.05.2023 dhe 09-7416/2 të datës 23.08.2023, u përgjigj ndaj kërkesave për të dhëna dhe informata shtesë nga ana e KMK-së.

Në përputhje me nenin 10 dhe nenin 15 paragrafi (4) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës solli Konkluzion nr. 10-1 të datës 04.10.2023 për ngritjen e procedurës për vlerësimin e lejueshmërisë së ndarjes së ndihmës shtetërore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes Zëvendëskryetarit të Qeverisë përgjegjës për çështje ekonomike, koordinim me resorët ekonomikë dhe investime, Fatmir Bitiqi, për shkak të faktit se ekzistojnë dyshime serioze për lejueshmërinë e ndarjes së ndihmës përmes masave të përmbajtura në Njoftimin për ndarjen e planifikuar të ndihmës shtetërore nr. 10-153 të datës 21.11.2022, përkatësisht për masat në Marrëveshjen për ndarjen e ndihmës shtetërore ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod. Dhënësi i ndihmës shtetërore, me shkresën nr. 09-10686/2 të datës 06.11.2023 (Nr. ynë 10-1 i datës 07.11.2023), u përgjigj ndaj Konkluzionit të sjellë nga KMK nr. 10-1 të datës 04.10.2023.

Në lidhje me Njoftimin e dorëzuar për ndarjen e planifikuar të ndihmës shtetërore Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime ATS AMMO SHPKNJP Samokov, Makedonski Brod, si dhe paketën e konceptuar të përfitimeve të përmbajtura në Marrëveshjen për ndarjen e ndihmës shtetërore, ndërsa në përputhje me nenin 15 paragrafi (5) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, KMK vlerëson se masat e krijuara paraqesin ndihmë shtetërore, ndarja e së cilës nuk lejohet për arsyet në vijim:

1. baza për ndarjen e ndihmës;
2. përfshirja retroaktive e periudhës (nga viti 2021) dhe zgjidhje të caktuara që janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes;
3. pasiguria e KMK-së në përmbushjen e parimeve të BE-së për ndarjen e ndihmës shtetërore;
4. mungesa e gatishmërisë që për këtë projekt investues të mbahet kontabilitet i dyfishtë;
5. karakteri eksportues i ndihmës për këtë investim; dhe
6. vlerësimi i tri masave të krijuara për mbështetjen e këtij investimi.

1. Duke i marrë parasysh përgjigjet e dhënësit të ndihmës shtetërore në Njoftimin për ndarjen e planifikuar të ndihmës, si dhe shkresën nr. 09-4045/1 të datës 19.04.2023, KMK vë në dukje faktin se Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore nuk mund të jetë bazë për ndarjen e ndihmës shtetërore. Me të njëjtin bëhet vlerësimi/miratimi, si dhe kontrolli/ushtrohet mbikëqyrja e ndihmës shtetërore tashmë të miratuar/të ndarë. Masat ekonomike nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore krijohen duke u bazuar në akte të tjera juridike – si skemë ndihme ose si ndihmë individuale, ndërsa me Ligjin për kontrollin e ndihmës shtetërore vlerësohet lejueshmëria/moslejueshmëria e ndarjes së ndihmës së tillë të paraparë me masat e konceptuara të tilla. Duke u nisur nga sa më sipër, KMK vlerëson nëse paketa e konceptuar e përfitimeve nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore është në përputhje me legjislacionin për ndihmë shtetërore dhe në bazë të nenit 3 paragrafi (3) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe me rregullat për ndihmë shtetërore në Bashkimin Evropian, por në asnjë rast Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore nuk mund të jetë bazë për ndarjen e ndihmës shtetërore (edhe pse kjo është theksuar në shkresën nr. 09-4045/3 të datës 22.05.2023 dhe në Njoftim). Emërtimi i ligjit për të cilin është kompetente KMK është „Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore” dhe jo „Ligji për ndarjen e ndihmës shtetërore”. Dhënësi i ndihmës shtetërore ndan ndihmë shtetërore me miratim paraprak nga ana e KMK-së në përputhje me vlerësimin për lejueshmërinë e ndarjes së ndihmës së tillë shtetërore të përcaktuar me Ligjin për kontrollin e ndihmës shtetërore.

2. Në Marrëveshjen për ndarjen e ndihmës shtetërore, në nenin 1, është theksuar se „data e fillimit” do të thotë 01.01.2021. Gjithashtu edhe në tri masat e dizajnuara në nenin 4.1 a), b) dhe v) të Marrëveshjes është theksuar se ndihma do të paguhet nga Data e fillimit, që përfshin periudhë retroaktive (nga 01.01.2021 siç është paraparë në Marrëveshje).

3. Në nenin 2, pika 2.3 e Marrëveshjes për ndarjen e ndihmës shtetërore, dhënësi garanton se ndihma shtetërore e miratuar me Marrëveshjen është në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi për ndihmë shtetërore. Sipas legjislacionit të BE-së për ndihmë shtetërore, ndihma shtetërore si instrument i politikës publike duhet të ndahet në rast kur ekziston dështim i tregut, që do të thotë kur tregu në mënyrë të pavarur dhe me forcat e veta nuk mund të sigurojë një produkt të caktuar ose të ofrojë një shërbim të caktuar pa ndihmë shtetërore. Në këtë rast tregu me forcat e veta ka siguruar produkt ose ka ofruar shërbim të pavarur (projekti investues është filluar nga viti 2021 pa

mbështetje publike). Në bazë të kësaj, qëllimi i dhënësit të ndihmës shtetërore për ndarjen e ndihmës përmes krijimit të paketës së përfitimeve, sipas KMK-së më shumë i ngjan shpërblimit ndaj subjektit juridik për suksesin që në mënyrë të pavarur ta fillojë projektin investues, e jo si ndihmë që do të ndahej për të tejkaluar një dështim të caktuar të tregut. Duke u nisur nga sa më sipër, dhënësi i ndihmës shtetërore nuk ka mundur të tregojë në mënyrë të argumentuar se sa është e sigurt që kompania nuk do ta realizonte plotësisht këtë ndërmarrje investuese me forcat e veta, duke marrë parasysh gjendjen financiare të kompanisë, por edhe ndoshta nevojën/qëllimin e saj për pozicionim më të mirë në treg në të ardhmen, që këtë projekt investues ta realizojë edhe pa ndarjen e ndihmës shtetërore, përkatësisht me mungesë të instrumentit të mbështetjes publike; sa është investimi realisht i arsyeshëm; cila është domosdoshmëria për realizimin e këtij projekti investues me përdorimin e instrumentit të ndihmës shtetërore; cilat do të ishin efektet pozitive dhe negative të ndihmës shtetërore të ndarë për realizimin e këtij projekti investues dhe të vlerësojë me çfarë shume minimale ndihma i prodhon efektet e dëshiruara.

4. Në shkresën nr. 09-111/8 të datës 10.03.2023 (Nr. ynë 10-1 i datës 17.03.2023), dhënësi i ndihmës shtetërore njofton se me realizimin e këtij projekti investues, 70% e prodhimit të kompanisë do të destinohet për eksport, ndërsa 30% e prodhimit për interesa esenciale ushtarake dhe të sigurisë së shtetit, përkatësisht për qëllime specifike ushtarake. KMK me shkresën nr. 10-1 të datës 03.04.2023 kërkoi informata lidhur me atë nëse me këtë projekt investues kompania do të mbajë kontabilitet të ndryshëm/të ndarë për shpenzimet dhe të hyrat që shërbejnë për interesat esenciale të sigurisë së shtetit, përkatësisht për nevojat vendore dhe kontabilitet të ndryshëm/të ndarë për shpenzimet dhe të hyrat për aktivitetet eksportuese që rrjedhin nga projekti investues. Në përgjigjen e dorëzuar nga dhënësi i ndihmës me shkresën nr. 09-4045/1 të datës 19.04.2023 është theksuar se kompania nuk do të mbajë kontabilitet të ndryshëm/të ndarë për shpenzimet dhe të hyrat që shërbejnë për interesat esenciale të sigurisë së shtetit, përkatësisht për nevojat vendore dhe kontabilitet të ndryshëm/të ndarë për shpenzimet dhe të hyrat për aktivitetet eksportuese që rrjedhin nga projekti investues. Lidhur me këtë lloj investimesh, KMK referon në nenin 346 (1) b) të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian, ku është theksuar: „çdo shtet anëtar mund të ndërmarrë masa të tilla që i konsideron të nevojshme për mbrojtjen e interesave esenciale të sigurisë së tij që lidhen me prodhimin ose tregtinë me armë, municion dhe material ushtarak; masat e tilla nuk do të ndikojnë negativisht mbi kushtet e konkurrencës në tregun e brendshëm lidhur me produktet që nuk janë të destinuara për qëllime specifike ushtarake”. Duke u nisur nga sa më sipër, KMK konsideron se masa të tilla ndaj këtij lloji të përfituesit janë të përjashtuara nga vlerësimi sipas rregullave për ndihmë shtetërore, por vetëm për interesat esenciale të sigurisë së shtetit.
5. Nevoja për dizajnimin e masave për mbështetjen e ekonomisë duhet të konceptohet në drejtim që do të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë dhe të kihet kujdes që ndihma e tillë të mos shkaktojë dëm të konsiderueshëm dhe të pariparueshëm ndaj konkurrencës. Në përputhje me legjislacionin për ndihmë shtetërore, çdo ndihmë, madje edhe ndihma de minimis (ndihma me rëndësi të vogël), nuk guxon të jetë e lidhur me aktivitetet eksportuese. Dizajnimi i masave mbështetëse që kanë karakter të ndihmës për eksport nuk lejohet në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndihmë shtetërore dhe rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë.

6. Sa i përket masave në Marrëveshje të dedikuara për mbështetjen e këtij investimi, KMK me shkresën nr. 10-1 të datës 28.02.2023 kërkoi nga dhënësi i ndihmës shtetërore të përgjigjet nëse ka marrë ndihmë shtetërore në bazë të ndonjë akti/skeme tjetër ndihme ose si ndihmë individuale. Dhënësi i ndihmës, me shkresën nr. 09-111/8 të datës 10.03.2023 (Nr. ynë 10-1 i datës 17.03.2023), u përgjigj se nuk ka marrë ndihmë të tillë. Përveç masave të theksuara në Marrëveshje, është e paqartë se cilat shpenzime të tjera të theksuara në nenin 1, pika (d) të Marrëveshjes do të paraqisnin shpenzime të arsyeshme investuese.

Për shkak të sa më sipër, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Në përputhje me nenin 26 paragrafi (3) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit, përveç në rast kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, ndarja e së cilës nuk lejohet.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**